



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
SHËRBIMI PËR ÇËSHTJET E BRENDSHME DHE ANKESAT



RAPORTI VJETOR 2020

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së

Të nderuar lexues,

Ndërsa uroj që kjo kohë t'ju gjejë me shëndet të plotë për ju dhe familjet tuaja, të paprekur nga pandemia Covid-19, e cila ka trazuar jo pak qetësinë e përditshmërisë së gjithësecilit prej nesh, është kënaqësia ime që edhe këtë vit, në kuadër të transparencës me publikun, t'ju prezantoj Raportin Vjetor të Punës së Shërbimit për Çështjet e Brendëshme dhe Ankesat.

Pavarësisht kufizimeve të imponuara nga situata e krijuar me Covid-19, edhe këtë vit ka vijuar intensivisht puna për rritjen e performancës së Shërbimit në lidhje me mbikqyrjen e strukturave të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe shërbimit Zjarrfikës, në përmbushje të misionit të Shërbimit për garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e interesave të ligjshëm të shtetit, si dhe të drejtave të shtetasve, nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të punonjësve të strukturave, pavarësisht nga funksioni dhe grada.

Kjo performancë mund të dallohet qartë në rritjen e numrit të inspektimeve, trajtimit të ankesave, numrit të subjekteve të proceduar, hetimeve proaktive në ndjekje, apo numrit të subjekteve ndaj të cilëve është marrë masë e sigurimit personal si: arrestime/ndalime, ose pezullime nga ushtrimi i funksioneve, etj.

Në këtë raport gjen pasqyrim e gjithë veprimtaria një vjeçare e Shërbimit në funksion të mbikqyrjes së jashtme të strukturave objekt i veprimtarisë së tij, si edhe treguesit kryesorë të arritur gjatë vitit 2020, si në aspektin e hetimit administrativ të ankesave dhe inspektimeve, ashtu edhe në hetimin penal të shkeljeve të ligjit, nga punonjës të strukturave.

Gjithashtu pasqyrohet angazhimi ynë maksimal në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga dokumentet strategjike ndërinstitucionalë dhe planeve konkrete të veprimit, në kuadër të proceseve integrale të vendit tonë në Bashkimin Europian, sikurse edhe prioritetet, objektivat dhe synimet tona për vitin 2021.

Vizioni ynë është shndërrimi i Shërbimit në një agjenci ligjzbatuese efektive tërësisht civile dhe në harmoni me kërkesat dhe standardet e EPAC-ut, që mbështetet në inovacionin teknologjik, angazhimin proaktiv në luftën kundër fenomeneve negative që prekin strukturat subjekt i veprimtarisë.

Gjatë vitit 2020, në interes të zhvillimit institucional dhe arritjes së standardeve, Shërbimi ka ndërmarrë një sërë reformash, si: hartimi/miratimi i Strategjisë për Zhvillimin e SHÇBA 2020-2024, hartimi/miratimi i Planit të Veprimit 2020- 2022, hartimi/miratimi i paketës ligjore e nënligjore për vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, hartimi/miratimi dhe implementimi i strukturës së re organike, implementimi i programit të Poligrafit, hartimi/miratimi i Projekt/ligjit të ri "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore", etj.

Zgjerimi i kompetencave ligjore të Shërbimit të parashikuara në Draft ligjin e hartuar, në harmoni me aktet e tjera që do të miratohen në zbatim të tij, implementimi i një sërë programesh

të avancuara teknologjike, etj; do të orientojnë punonjësit tanë drejt një qasje të re proaktive në luftën kundër korrupsionit dhe fenomeneve negative, njohjen permanente të publikut me veprimtarinë e Shërbimit si dhe rritjes së besimit ndaj strukturave të Shërbimit.

Falenderoj publikun për mbështetjen që kanë dhënë për përmbushjen e misionit tonë përmes bashkëveprimit dhe mbikqyrjes së jashtme qytetare në funksion të zbatimit të ligjit nga strukturat e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe shërbimit Zjarrfikës.

Uroj që ky Raport të rrisë dhe forcojë edhe më tej bashkëpunimin Shërbim–publik, përmes informimit dhe transparencës me qytetarët.

PASQYRA E LËNDËS

I. HYRJE.....	3
I.1. Realizimi i prioriteteve dhe objektivave të planifikuara për vitin 2020	
I.2. Vlerësimi i mjedisit dhe masat e marra për përmirësimin e saj	
I.3. Rezultatet e vitit 2019 dhe pritshmëritë për rritje cilësore dhe sasiore në vitin 2020	
I.4. Projektet dhe reformat e ndërmarra në vitin 2020	
II. VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË INSPEKTIMIT DHE ANKESAVE.....	6
II.1. Veprimtaria e trajtimit të ankesave	
II.2. Administrimi i ankesave	
II.3. Problematikat e konstatuara gjatë trajtimit të ankesave	
II.4. Veprimtaria inspektuese	
II.5. Problematika të nxjerra nga metoda mbikqyrëse e inspektimeve sipas subjekteve	
III. VEPRIMTARIA PROCEDURALE PENALE E DREJTORISË SË HETIMIT.....	11
III.1. Rezultatet e vitit 2019 dhe pritshmëritë për rritje cilësore dhe sasiore në 2020	
III.2. Veprimtaria procedurale penale	
III.3. Operacione të Sukseshme të Hetimeve Proaktive	
III.4. Veprimtaria Administrative	
IV. VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË ANALIZËS.....	14
V. VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË VLERËSIMIT KALIMTAR E PERIODIK.....	16
VI. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE.....	17
VI.1. Për menaxhimin e shërbimeve Logjistike	
VI.2. Për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe trajnimeve	
VI.2.1. Masat disiplinore	
VI.3. Për rrjetet dhe sistemet e TI-së	
VI.4. Projekte të realizuara për vitin 2020 në mënyrë të përmbledhur	
VI. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021.....	20

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si strukturë e veçantë e Ministrisë së Brendshme, ka për mision garantimin e zbatimit të ligjit, mbrojtjen e interesave të ligjshëm të shtetit, si dhe të drejtave të shtetasve, nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme të subjekteve të Shërbimit, pavarësisht nga funksioni dhe grada.

Shërbimi mbikëqyr dhe kontrollon strukturat e Policisë së Shtetit nëpërmjet:

Marrjes dhe shqyrtimit të ankesave të ardhura nga publiku për punonjës të Strukturave, që nga sjelljet jo etike e deri tek shkeljet e ligjit

Kryerjes së inspektimeve për performancën e tyre, në përputhje me ligjin dhe standardet e kërkuara

Hetimit të veprave penale të kryera nga punonjësit e strukturave, si dhe shkeljeve të tjera të ligjit

Kryerjes së testit të integritetit për punonjësit e strukturave

Kontrollit të pasurisë së pajustificuar të punonjësve të strukturave mbi bazën e ankesave dhe kallëzimeve

Kryerjes së analizave, studimeve e rekomandimeve, mbi bazën e protokolleve të inspektimit dhe raporteve të hetimit, për mënyrën e organizimit e funksionimit të Strukturave dhe pritshmërisë së publikut për sigurinë publike

Veprimtaria e Shërbimit normohet në bazë të Ligjit Nr. 70/2014, “Për Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ligjit 10/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SHÇBA-së”.

I.1. Realizimi i prioriteteve dhe objektivave të planifikuara për vitin 2020

Për Ministrinë e Brendshme dhe strukturat përbërëse të saj, ashtu sikurse edhe për të gjithë vendin dhe shoqërinë shqipëtare, viti 2020 ishte tepër i veçantë, pasi që në fillim u përballëm me fenomene të reja masive të panjohura me parë, si; eliminimi i pasojave nga tërmeti që goditi vendin në muajin Nëntor 2019 dhe më pas shfaqja në nivel botëror i Pandemisë Covid 19. Detyrimisht, ngjarje të tilla madhore do të ndikonin edhe në riplanifikimin e objektivave dhe prioriteteve të parashikuara për vitin 2020.

Ky vit do të fillonte me ndjekjen nga afër të Planit të Veprimit 2 vjeçar (2020-2022), i cili kishte për qëllim shndërrimin e Shërbimit, nga një strukturë e mbyllur dhe e shkëputur nga mjedisi që e rrethon, në një instrument të specializuar mbikqyrës, transparent dhe antikorrupsion, në respekt të

lirive e të drejtave të qytetarit, duke i shërbyer komunitetit në trajtimin e ankesave dhe shqetësimeve të tij në raport me shkeljet apo abuzimet e subjekteve.

Planifikimi dhe marrja e masave për realizimin e objektivave është rrjedhë logjike e Programit të Qeverisë e Ministrisë së Brendshme, si dhe e detyrimit ligjor që ka Shërbimi. Nga ky këndvështrim, veprimtaria që do përbënte sfidë për SHÇBA, mund të sintetizohet në aksiomën *“Eficiencë për të mbikëqyrur ushtrimin e autoritetit Policor dhe të organeve të tjera ligjzbatuese për të parandaluar shkeljet e ligjshmërisë dhe korrupsionin, me qëllim që të garantohen gjithnjë e më mirë të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve”*.

I.2. Vlerësimi i mjedisit dhe masat e marra për përmirësimin e saj

Veprimtaria institucionale e funksionale e strukturave të Shërbimit gjatë 2020 u ndikua nga një sërë faktorësh e rrethanash të brendshme e të jashtme, duke e drejtuar në çështje parësore.

Situata pas tërmetit Nëntor 2019

Shërbimi pati një reagim të menjëhershëm, jo vetëm në vlerësimin e situatës, por edhe në marrjen e masave me karakter organizues, hetimor e inspektues me të gjithë burimet njerëzore që ajo administron e menaxhon, për përballimin e situatës së krijuar dhe monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar. Kështu, u bë plotësimi me akte normative të kompetencës së Drejtorit të Përgjithshëm për këtë situatë, me 2 (dy) Urdhëra dhe 2 (dy) Plane Masash.

Ngritja e funksionimi i Grupeve të Drejtimit për veprimet hetimore e inspektuese ishte pjesë e organizimit dhe monitorimit të kësaj situatë. Grupet e drejtimit të ngritura si në qendër, apo në nivelin vendor e sidomos në vatrë të tërmetit pranë Drejtorive Rajonale Durrës – Lezhë dhe Tiranë, do të kryenin monitorimin e vazhdueshëm ndaj strukturave të Policisë së Shtetit për evidentimin e çdo rasti të dyshimtë apo abuziv nga punonjësit e Strukturave.

Pandemia e krijuar nga COVID-19


Fenomen tepër i veçantë për të cilën në vlerësimin e Qeverisë u miratua Akti normativ nr. 3, Datë 15.03.2020 të Këshillit të Ministrave, *“Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”*,

Për të bërë menaxhimin tepër specifik të detyrave, të cilat në tërësinë e tyre kërkonin angazhim dhe bashkëpunim me institucionet e tjera ligjzbatuese në nivel qendror e vendor, si edhe për të sqaruar strukturat për përgjegjësitë e Shërbimit në lidhje me situatën e krijuar, ishte domosdoshmëri nxjerrja e akteve të brendshme. Kështu, u miratuan 2 (dy) Plane Masash dhe 1 (një) Akt Normativ në lidhje me këtë situatë.

Pranë Shërbimit, nëpërmjet linjës së gjelbër **08009090**, e cila pavarësisht situatës së krijuar ka funksionuar me personel nga ora 08:00 – 20:00 janë adresuar shumë telefonata, ku pjesa më e madhe e tyre ka qenë në lidhje me kufizimet e lëvizjes së mjeteve dhe qytetarëve.

I.3. Rezultatet e vitit 2019 dhe pritshmëritë për rritje cilësore dhe sasiore në vitin 2020

Viti 2020, për Shërbimin nisi mbi një situatë me tregues pozitivë për vitin 2019, tregues këta të vlerësuar si më të lartë në sasi dhe cilësi. Në fushën e hetimit kemi treguesit e mëposhtëm:



I.4. Projektet dhe reformat e ndërmarra në vitin 2020

Gjatë vitit 2020, në interes të zhvillimit institucional dhe arritjes së standardeve, Shërbimi ka ndërmarrë një sërë reformash, e konkretisht:

- Hartimi/miratimi i Strategjisë për Zhvillimin e SHÇBA 2020 – 2024;
- Hartimi dhe miratimi i Planit të Veprimit 2020 – 2022;
- Implementimi i Sistemit të Menaxhimit të Çështjes/Moduli i Ankesave dhe Hetimit Procedural Penal;
- Hartimi dhe miratimi i paketës ligjore e nënligjore për vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit;
- Hartimi, miratimi dhe implementimi i strukturës së re organike;
- Përmirësimi i infrastrukturës teknologjike të Shërbimit dhe fillimi nga puna e sistemeve kompjuterike, Programi kompjuterik analitik IBase, Sistemi analitik i tabulateve telefonike i2;
- Rekrutimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i burimeve njerëzore të domosdoshme në raport me përgjegjësitë e Shërbimit;
- Implementimi i programit të Poligrafit dhe rezultatet e para të tij;
- Hartimi/miratimi dhe adresimi në Këshillin e Ministrave i Projekt/ligjit të ri "Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore";


Në përmbushjen e detyrimeve ndaj prioriteteve dhe objektivave për vitin 2020, janë ndjekur nga afër të gjitha masat e Planit të Veprimit, ku prioritetet prevalonin në varësi të situatës. Kështu, gjatë muajve Mars - Korrik 2020 prioritet ishte Plani i Veprimit **kundër kultivimit të kanabisit**. Në saj të masave të marra dhe përfimit të informacionit në kohën e duhur u evidentuan dhjetra raste me një forcë reaguese tepër eficiente, krahasuar kjo me një vit më parë.

Po kështu, u vlerësuan dhe u trajtuan edhe inspektimet për masat anticovid në shkallë vendi, apo edhe për paligjshmëritë që u vunë re, me tendenca edhe korruptive ndaj autorizimeve që kishte të drejtë të jepte policia në raport me këto masa, si leje lëvizje, zbatimi i orarit policor, mbyllje lokalesh, mbajtje maskash, etj.

II.1. Veprimtaria e trajtimit të ankesave

Nga Zyra e Ankesave janë marrë gjithsej **8113** telefonata, ku pas analizimit, ka rezultuar se:

- **2723** telefonata kanë qenë brenda objektit të punës së SHÇBA-së.
- **1112** telefonata kanë qenë me objekt informacion, në lidhje me veprimtarinë e SHÇBA-së.
- **4278** telefonata kanë qenë jashtë fushës së veprimtarisë së SHÇBA-së. Shtetasve u është dhënë informacioni i kërkuar dhe janë adresuar pranë strukturës përkatëse ku duhet të depozitohen ankesën e tyre.


Telefonata 2017 - 2020

Rritja në numër e telefonatave përgjatë vitit 2020 ka ardhur jo vetëm për shkak të rritjes së profesionalizmit dhe transparencës në trajtimin e ankesave, gjë që tregon për një rritje të besueshmërisë së publikut ndaj Shërbimit, por edhe për faktin e situatës së pandemisë dhe kufizimeve të lëvizjeve, ku në pamundësi komunikimi me policinë në numrat e emergjencës 129 dhe 112, shtetasit i janë drejtuar linjës së gjelbër **0800 90 90** për informacion.


Rritja e besimit obligon strukturat e Shërbimit për vlerësimin në kohë të tyre dhe realizimin e procesit të verifikimit duke dhënë përgjigjen e duhur qytetarit si dhe rrugën e zgjidhjes kur ajo ka të bëjë me institucione të tjera ligjzbatuese.

II.2. Administrimi i ankesave


Ankesat sipas strukturave



Ankesat sipas objektit



Të dhëna krahasuese 2017 - 2020



Krahasuar me vitin 2018 dhe 2019 kemi një rënie të numrit të ankesave, të cilat vijnë kryesisht si rezultat i situatës së pandemisë gjatë vitit 2020. Gjithashtu pavarësisht numrit më të ulët të ankesave është rritur numri i ankesave që kanë ardhur drejtpërdrejtë pranë Shërbimit, çka tregon se kemi një rritje të besimit të qytetarëve tek Shërbimi.

Viti	Raste penale nga ankesat	Hetime disiplinore nga ankesat
2018	9 raste me 16 punonjës	125 raste; 224 punonjës të strukturave
2019	3 raste	118 raste; 215 punonjës të strukturave
2020	10 raste me 29 punonjës policie	97 raste; 191 punonjës të strukturave

II.3. Problematikat e konstatuara gjatë trajtimit të ankesave

Nga trajtimi i ankesave si metodë mbikqyrëse ka rezultuar se punonjësit e strukturave si ato të policisë rrugore, të rendit e të sigurisë, të luftës kundër krimeve në komisarate e posta policie, flasin për mungesë etike dhe profesionalizmi. Por ka edhe shqetësime më të medha sidomos në rastet e ndalimeve e shoqërimeve, duke mos respektuar procedurat standarde për këtë qellim.

Për shkak të volumit të veprimeve në periudhën e karantinës dhe faktit që numri i emergjencave 112 nuk ka qenë i arritshëm, ka pasur një fluks mbi normalen të telefonatave në linjën e gjelbër **0800 90 90**. Këto telefonata kanë pasur të bëjnë me informacione në lidhje me lëvizjet dhe kufizimet në kuadër të masave anti COVID.

II.4. Veprimtaria inspektuese

Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar **88** inspektime në 62 struktura, subjekte të Shërbimit. Krahasimisht me vitin 2019 vërehet një rritje me 15 inspektime e konkretisht:



- 29 inspektime të planifikuara për vitin 2020, krahasuar me vitin 2019, vërehet një rritje me 19 inspektime të planifikuara.
- 59 inspektime të paplanifikuara, të cilat janë iniciuar nga ngjarjet e ndodhura, publikimet në media dhe problematika të raportuara nga qytetarë ose institucione të ndryshme. Në krahasim me vitin 2019 kur janë realizuar 63 inspektime vërehet një ulje e lehtë e numrit të inspektimeve të paplanifikuara me 4 të tilla. Në përfundim të veprimtarisë inspektuese:
 - ✓ Janë referuar materialet procedurale në Prokurori për 2 (raste). Krahasuar me vitin 2019 ka ulje me 7 raste të referuara.
 - ✓ Janë dhënë 282 rekomandime për përmirësim të problematikave të evidentuara. Krahasuar me vitin 2019 ka rritje me 101 rekomandime.
 - ✓ Sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për 83 punonjës të Policisë së Shtetit, (34 Inspektorë; 47 N/Komisarë dhe 2 Komisarë) dhe 6 punonjës të SHMNZSH Durrës. Krahasuar me vitin 2019 kur është sugjeruar fillimi i hetimit disiplinor për 265 punonjës, ka ulje me 176 raste.

Për periudhën në analizim janë zhvilluar gjithsej 28 inspektime të përbashkëta me Drejtorinë e Hetimit. Krahasuar me vitin 2019, janë kryer 15 inspektime të përbashkëta më shumë, e konkretisht:

- 25 raste me Drejtorinë e Hetimit.
- 2 raste me Drejtorinë e Auditit në Ministrinë e Brendshme.
- 1 rast me Drejtorinë e Përgjithshme të SHMNZSH.

Bashkëpunimi me këto struktura synohet që të shtrihet edhe më tej, për vitin 2021.

Treguesit e inspektimeve



Në aspekt krahasimor për periudhën 2018 – 2020 veprimtaria inspektuese paraqitet si vijon:


Viti	Inspektime			Referime	Rekomandime	Masa disiplinore	Të përbashkët
	Planifikuar	Paplanifikuar	Total				
2018	6	30	36	2 (5 persona)	73	528	1
2019	10	63	73	9 (30 persona)	181	265	13
2020	29	59	88	2 (pa autor)	282	89	28

Gjatë vitit 2020 kemi rritje në:

- ↑ numrin e inspektimeve, me 15 inspektime, ose 17% më shumë
- numrin e rekomandimeve për përmirësimin e punës, me 101, ose 155% më shumë
- numrin e inspektimeve të përbashkëta, me 15, ose 215% më shumë

Ndërkohë, kemi ulje në numrin e rekomandimeve për masa disiplinore si dhe referime të veprave penale. Kjo ka ndodhur për shkak edhe të pandemisë, e cila ka zgjatur gjatë gjithë vitit, ku kemi pasur një numër me të lartë inspektimesh të iniciuara nga qytetarët, të cilët kanë kundërshtuar masat anti Covid.

Dinamika e inspektiveve 2018 - 2020



II.5. Problematika të nxjerra nga metoda mbikqyrëse e inspektiveve sipas subjekteve

Problematika në Policinë e Shtetit

Strukturat e hetimit të krimit

Në strukturat e Hetimit të Krimit në Policinë e Shtetit janë kryer 41 inspektive; në DPPSH (OFL), si dhe 12 Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Komisariatet në varësi. Janë dhënë 262 rekomandime për përmirësimin e punës dhe 24 rekomandime për fillim të hetimit disiplinor.

Masat e marra për parandalimin e veprimtarisë së kultivimit të bimëve narkotike

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore, Shërbimi zhvilloi një inspektim të planifikuar në të gjithë Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Komisariatet në varësi. Në strukturat e Sigurisë Publike janë kryer 21 inspektive, dhënë 7 rekomandime, si dhe 22 rekomandime për fillim të hetimit disiplinor.

Inspektimet janë shtrirë edhe në disa struktura të veçanta si në *Policinë Rrugore*, ku janë kryer 10 inspektive, dhënë 14 rekomandime si dhe 11 rekomandime për fillim të hetimit disiplinor.

Në strukturat e *Kufirit dhe Migracionit* janë kryer 8 inspektive, dhënë 13 rekomandime si dhe 22 rekomandime për fillim të hetimit disiplinor. Nga inspektimet janë hasur problematika në lidhje me monitorimin dhe kontrollin e vijës kufitare (blu/gjelbër), duke nisur nga mungesa e burimeve njerëzore, infrastrukturë logjistike, radarëve lokalë e deri tek mjetet defekte në dispozicion.

Problematika në strukturat e SHMZSH

Në strukturat e Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi është zhvilluar 1 (një) inspektim i përbashkët me Drejtorinë e Përgjithshme të SHMZSH-së ku janë dhënë 8 rekomandime dhe 6 rekomandime për fillim të hetimit disiplinor. Në përfundim të inspektimit rezultuan disa probleme me procedurat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore që normojnë veprimtarinë e kësaj strukture. Me shumë vend ishin gjetjet që lidhen me numrin e punonjësve të këtij shërbimi në raport me numrin e banorëve të zonave ku ato veprojnë.

Kështu, Drejtoria e SHMZSH-Durrës ka 1 punonjës për 6249 banorë, Stacioni i SHMZSH-Shijak ka 1 punonjës për 3150 banorë, Stacioni i SHMZSH-Krujë ka 1 punonjës për 5686 banorë. Strukturat e inspektimit të Shërbimit për vitin 2020 kanë kryer edhe veprime procedurale, ku kanë gjetur elementë të konstatimit të veprave penale, duke referuar materialet sipas përkatësisë në organin e prokurorisë.

III.

VEPRIMTARIA PROCEDURALE PENALE E DREJTORISË SË HETIMIT

III.1. Rezultatet e vitit 2019 dhe pritshmëritë për rritje cilësore dhe sasiore në 2020

Edhe për strukturat e hetimit, viti 2020 nisi mbi një situatë me tregues pozitivë që prej vitit 2019, tregues këta të vlerësuar disa herë më të lartë në sasi dhe cilësi me treguesit e dy – tre viteve të fundit të veprimtarisë së strukturave të hetimit të Shërbimit, duke vlerësuar kështu një:



Rritje me **78% të numrit të subjekteve të proceduar**

Rritje me **149% të numrit të subjekteve** ndaj të cilëve është marrë masa sigurimi personal si; arreste/ndalime ose pezullime nga ushtrimi i funksioneve, etj,

Rritje me **136% të hetimeve proaktive.**

Forcimi i kapaciteteve të brendshme të strukturave të hetimit

Për të përballuar impaktin e faktorëve të jashtëm (*situata e tërmetit dhe pandemia e Covid – 19*) në veprimtarinë e përditshmërisë së strukturave të hetimit, sigurimit të personelit, apo dhe aplikimit të formave të ndryshme të mbikëqyrjes janë propozuar dhe miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm **18 akte** normative, nga të cilat:

- **5 Urdhra,**
- **6 qarkore,**
- **4 Plane Masash**
- **3 Tërheqje Vëmendje**

Kjo bazë ligjore ka ndihmuar në çështjet e organizimit të procesit informativ, në interes të përfuturit dhe analizimit të informacionit, si dhe çeljen e procesve verifikuese apo gjurmuese ndaj subjekteve të ndryshme për të cilët kishte të dhëna për abuzime, veprime arbitrare, apo implikime gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

III.2 Veprimtaria procedurale penale

Kjo veprimtari, si më e rëndësishmja dhe një nga shtyllat kryesore të Shërbimit, për vitin 2020 ka arritur nivele shumë të kënaqshme në të gjitha komponentët; sasi, cilësi dhe në figurat e veprave penale të përcaktuara në programin vjetor si prioritare dhe fenomene shqetësuese.

Tehu kryesor kanë qënë hetimet proaktive informativo-gjurmuese në përdorim të metodave speciale të hetimit dhe ato të referuara e të deleguara për përfundim të tyre nga strukturat tona, të cilat për rrjedhojë janë referuar pranë organit të Prokurorisë.

Përveç procedimeve penale të mbartura nga viti **2019** dhe që janë gjithsej **102**, sektorët e hetimit të SHÇBA kanë arritur treguesit si më poshtë:

Referime të reja për vitin 2020, dërguar pranë organit të Prokurorisë

214 referime penale për 317 subjekte

1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues,
 98 punonjës policie të nivelit të parë drejtues,
 208 punonjës policie të nivelit zbatues,
 1 punonjës civil (administrativ),
 5 efektivë të Gardës,
 4 PMNZSH

Zbatuar vendime të gjykatave për masat "Arrest në flagrancë/ndalime/masa të tjera", ndaj **84 personave**


Arrestuar/ndaluar 84 personave

1 punonjës policie i nivelit të mesëm drejtues
 17 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
 23 punonjës policie të nivelit zbatues
 1 efektiv i PMNZSH-së
 2 efektivë të Gardës
 41 shtetas

Me masa të tjera të sigurimit personal, si; "pezullimi i ushtrimit të një detyre apo shërbimi publik", **31 persona**

13 punonjës policie të nivelit të parë drejtues
 16 punonjës policie të nivelit zbatues
 1 punonjës administrativ
 1 shtetas me masë "detyrim paraqitje tek OPGJ"

Periudha	Tregues krahasimor për rastet e kultivimit					
	Nr. procedimesh	Nr. i punonjësve të proceduar	Nr. punonjësish sipas nivelit			Nr. punonjësish të arrestuar/ ndaluar/ masë sigurimi
			Niveli i mesëm drejtues	Niveli i parë drejtues	Niveli zbatues	
VITI 2019	31	76	-	28	48	15
VITI 2020	33	73	-	24	49	30



Periudha	Tregues krahasimor për rastet e korrupsionit & shpërdorim detyre					
	Nr. procedimesh	Nr. i punonjësve të proceduar	Nr. punonjësish sipas nivelit			Nr. punonjësish të arrestuar/ ndaluar/ masë sigurimi ¹
			Niveli i mesëm drejtues	Niveli i parë drejtues	Niveli zbatues	
VITI 2019	141	287	3	87	197	63
VITI 2020	101	171	1	66	104	45

Në vitin 2020 kemi **330 procedime penale**, pra një rritje me 80 procedime penale, ose **13.2% me shumë** se viti 2019 dhe dinamika e tyre është:

- **22** raste, ose **6.6%** të referimeve me Vendim mos fillimi
- **36** raste, ose **10.9%** të procedimeve me Vendim pushimi
- **2** raste, ose **0.6 %** të procedimeve me Vendim pezullimi
- **145** raste, ose **43.9** të procedimeve janë deleguar për hetime të plota
- **50** raste, ose **16 %** të procedimeve dërguar për gjykim
- **75** raste, ose **23 %** të procedimeve ndiqen nga vetë prokuroria

Ajo që për këtë vit vlen të theksohet, janë **procedimet penale të hetuara me Prokurorinë e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)**, gjithsej **24 procedime penale**. Të cilat për vetë konstruktin dhe kriteret që duhet të plotësojnë, janë procedime që kërkojnë nivel të lartë profesional dhe integritet. Hetimet e kryera me SPAK, përveç sa tregohen në statistika, janë hetime të vlerësuara nga titullarët dhe prokurorët e këtij institucioni. Të gjitha procedimet janë premtuese, po ndiqen me metoda speciale të hetimit, me plane hetimore të përbashkëta dhe bashkëpunimi me prokurorët e SPAK, kanë qenë në nivel maksimal pozitiv.

III.3. Operacione të Sukseshme të Hetimeve Proaktive

Nga strukturat e hetimit të Shërbimit janë kryer rreth **19 operacione** për zbulimin, dokumentimin ligjor dhe goditjen e paligjshmërisë së punonjësve të policisë në format dhe fenomenet më shqetësuese, siç janë *“korrupsioni pasiv”*, *“shpërdorimi idetyrës”*, *favorizimi i “kultivimit të bimëve narkotike”* e *“kontrabandës”*, dhe *tendencave të tjera*.

Këto operacione janë realizuar në bashkëpunim me SPAK, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë dhe strukturave të Policisë së Shtetit, duke u finalizuar me dokumentimin me prova ligjore të veprimtarisë së kundërligjshme të punonjësve të policisë dhe shtetasve të implikuar, si dhe ekzekutimit të masave të sigurimit personal shtrëngues dhe ndalues të dhëna nga Gjykata e Posacme dhe ato të Rretheve Gjyqësore të Shkallës së Parë.

III.4. Veprimtaria Administrative

Në këtë shtyllë të veprimtarisë që kryen Departamenti i Hetimit dhe strukturat përbërëse të saj ka patur një impuls pozitiv krahasuar me vitet e tjera. Ky ndryshim ka të bëjë, si me mekanizmin e trajtimit, ashtu dhe me metodikat e punës së ndjekur gjatë trajtimit të korrespondencës. Një vend të rëndësishëm në këtë veprimtari gjejnë dhe inspektimet e brendshme, të cilat janë kryer nga Sektori i Policisë Gjyqësore dhe Sektori i Menaxhimit të Burimeve të Informacionit. Gjithçka është kanalizuar dhe thjeshtuar në kuptimin e marrjes, trajtimit dhe zgjidhjes së praktikave dokumentare sipas zonave dhe kompetencave të specialistëve të drejtimit.

¹ Pjesa tjetër e punonjësve ndiqen në gjendje të lirë

Metodika e re e organizimit të Shërbimit në nivel qendror dhe vendor, për sa i përket “Ndarjes së Zonave Funktionale”, reformë e kryer në vitin 2020, solli një ndryshim në rritjen e përgjegjësisë, por kryesisht në rikonceptimin e saj për të njohur gjendjen dhe për të qenë më afër subjekteve që mbikqyrin dhe përballjen me rrethin e problemeve që konstatohen. Ky organizim ndikoi dhe në nivelin qendror që çdo specialist drejtimi të ndjekë linjën e tij, për të qenë më afër për ndihmë e kontroll, si dhe për të çelur veprimtari gjurmuese apo procedurale vetë. Për të patur një tablo të qartë të veprimtarisë administrative për vitin 2020, kryesisht të Sektorit të Policisë Gjyqësore, të dhënat janë si më poshtë:

- Inspektive të Drejtorisë së Hetimit: 8 raste
- Inspektive të përbashkëta me Drejtorinë e Inspektimit: 16 raste

Këto inspektive janë zhvilluar për tematika të ndryshme e të iniciuara nga ngjarjet e ndodhura, publikimet në media dhe problematika të raportuara nga qytetarë ose institucione të ndryshme. Veprimtaria administrative e Drejtorisë së Hetimit është shtrirë edhe në detyrimet që ajo ka në hartimin e praktikave për verifikime të ankesave të shtetasve, apo kthim përgjigje dhe trajtim praktikash, kryesisht me DPPSH dhe DSP, ku janë shënuar:

- 52 praktika shkresore (përfshihet korrespondenca e klasifikuar)
- Memo Informuese në 36 raste, mbi çështje që lidhen me arrestimet në flagrancë, ekzekutimet e masave të sigurisë me vendim gjykate, mbi verifikimet paraprake të kryera për çështje me impakt në publik për sa i përket rendit dhe sigurisë publike, etj.
- Trajtime ankesa në 79 raste të tilla

IV.

VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË ANALIZËS

Në përmbushje të përgjegjësisë ligjore dhe detyrave funksionale si dhe dokumenteve strategjike e Programit Vjetor të Punës 2020, janë ndjekur dhe realizuar një sërë detyrash që lidhen me raportimet ndaj të tretëve, si dhe detyrat specifike.

E rëndësishme për këtë strukturë për vitin 2020, ka qenë realizimi i blerjeve të programeve analitike të informacionit kriminal, vënia në efencë të plotë e tyre si dhe përfundimi i instalimit të programit të Menaxhimit të Çështjes/Moduli i Hetimit Procedural Penal. Këto reforma i shërbejnë rritjes së kapaciteteve analitike të Shërbimit në interes të hetimit, inspektimit dhe çdo gjë tjetër për produkte cilësore gjatë trajtimit të çështjeve.

Disa nga drejtimet e veprimtarisë që ka ndjekur kjo strukturë janë:

- Hartimi dhe përgatitja e materialeve analitike dhe raportuese për Drejtorin e Përgjithshëm dhe Ministrin e Brendshëm:
 - Përgatitja e Analizave Periodike “Mbi veprimtarinë dhe treguesit kryesorë të punës së strukturave të Shërbimit”.
 - Përgatitja e materialit periodik të “Buletinit Informativ të Shërbimit”.
 - Përgatitja e akteve normative me efekt rregullator si “Qarkoret dhe Tërheqje vëmendje” të Drejtorit të Përgjithshëm.
 - Organizimi dhe ndjekja e punës në administrimin dhe përpunimin e treguesve statistikor, për:

- a) *Masat disiplinore dhe vendimet e komisionit të apelimit (Policia e Shtetit adresuar SHÇBA-së.*
 - b) *Referimet penale të referuara pranë organit të Prokurorisë nga strukturat vendore dhe qendrore dhe ecurinë e procedimeve penale përgjatë vitit 2020.*
 - c) *Administrimin e vendimeve të mos fillimit, pushimit, pezullimit apo gjykimit për procedimet penale të strukturave qendrore dhe vendore të Shërbimit.*
- Angazhimi, pjesëmarrja në grupe pune institucionale dhe ndërinstitucionale, brenda e jashtë vendit dhe raportimi periodik për realizimin dhe përbushjen e detyrimeve në kuadër të procesve integruese të vendit tonë në Bashkimin Evropian, e konkretisht;
 - *Grupin e punës pranë DSIK, në kuadër të procesit të Vetingut të “Gjyqtarëve dhe Prokurorëve” sipas ligjit nr. 84/2016.*
 - *Përfaqësimi në Grupin Ndërinstitucional të Punës për Integrimin European (GNPIE) për Kapitujt “Kriteri Politik” dhe “Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut”, ku institucion lider është Ministria e Drejtësisë.*
 - *Raportimi në kuadër të takimeve periodike të “Nën komitetit për Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë” BE- Shqipëri.*
 - *Raportimit në kuadër të takimeve periodike të Bashkimit Evropian – Shqipëri, Komiteti i Stabilizim – Asociimit.*
 - *Raportimit në lidhje me “Raport – Progresin e përvitshëm”, të Bashkimit Evropian Për Shqipërinë.*
 - *Raportimit për grupin e ekspertëve të GRECO-s në lidhje me “Raportin e Raundit të Pestë të Vlerësimit të GRECO-së për Shqipërinë”.*
 - *Raportimit për përbushjen e të detyrimeve që lidhen me “Planin e Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit 2017 – 2020”.*
 - *Raportimit mbi treguesit statistikor të Shërbimit në kuadër të raportimit javor për Kryenegociatorin e Shqipërisë, mbi ecurinë e përbushjes së kushteve dhe rekomandimeve për procesin e negociimit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE*
 - *Raportimit për DAP (Departamentin Amerikan të Shtetit) mbi çështje që lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore dhe implikimit të mundshëm të punonjësve të policisë si dhe në funksion të “Raportit Global të të drejtave të Njeriut”, etj.*
 - Strukturat përbërëse të Drejtorisë së Analizës kanë ndjekur dhe realizuar kryerjen e procedurave për administrimin, ruajtjen dhe veçim për asgjësimin e informacioneve të marra nga specialistët e hetimit në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e informacionit të klasifikuar *Sekret Shtetëror*.
 - Drejtoria e Analizës nëpërmjet Sektorit të Sigurisë së Personelit, ka organizuar dhe ndjekur punën për procesin e verifikimit të praktikave në kuadër të aplikimit të personave për Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP), procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve/prokurorëve sipas ligjit 84/2016 e deri në realizimin e procesit të verifikimit të kandidatëve për strukturat e reja të drejtësisë, sipas ligjit 96/2016.

Në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 3217, datë 26.11.2020 “*Për funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Praktikave për pajisjen me CSP*”, praktikat e prodhuara nga Sektori i Sigurimit të Personelit për pajisjen me CSP të punonjësve të strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit, i janë nënshtruar vlerësimit dhe gjykimit të këtij komisioni për adresim pranë

Autoritetit Kombëtar të Sigurisë “DSIK” për “plotësim, ose jo të kushteve të sigurisë dhe të ekzistencës së rrezikut të papranueshëm të sigurisë”. Në këtë kontekst, janë vlerësuar për CSP:

- 1416 punonjës, subjektet e Shërbimit,
- 794 punonjës të Operatorëve Ekonomik,
- 2288 punonjës të Institucioneve Shtetërore,
- 395 prokurorë/gjyqtarë/institucionet e drejtësisë
- 46 punonjës të vetë Shërbimit

Në përfundim të procedurave verifikuese nga ana e Shërbimit, për punonjësit e strukturave, objekt i veprimtarisë së Shërbimit, janë adresuar pranë DSIK 115 raste, subjekte të Shërbimit, të vlerësuara “që përbëjnë rrezik për pajisjen me CSP”, në kuadër të aksesit dhe njohjes me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, ku deri më tani nga DSIK është njoftuar refuzimi i pajisjes me CSP për gjithsej 75 punonjës policie.

V.

VEPRIMTARIA E DREJTORISË SË VLERËSIMIT KALIMTAR DHE PERIODIK

Referuar përgjegjësi të reja të përcaktuara në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, SHÇBA-së dhe Gardës së Republikës”, Shërbimi ngarkohet me detyrimin e vlerësimit kalimtar dhe periodik dhe kryerjen e ekzaminimeve poligrafike kalimtare dhe periodike për punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në këtë kuadër për t’i paraprirë të dy proceseve, nga Drejtuesi i Shërbimit janë ndërmarrë një sërë iniciativash, masash dhe aktiviteteve me qëllim mbarëvajtjen në vijim, e konkretisht:

- U krijua Drejtoria e Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik, e përbërë nga dy sektorë, Sektori i Trupave të vlerësimit (1+11), i cili do ketë atributet e vlerësimit kalimtar dhe periodik të subjekteve të përcaktuara në ligj, si dhe Sektori i Poligrafit (1+4), i cili ka atributet e kryerjes së ekzaminimit poligrafik, një risi e re jo vetëm në Shërbim, por dhe në Republikën e Shqipërisë.
- U hartua dhe miratua programi i punës nr. 497, datë 11.03.2020 për procesin e Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik të bazuar dhe në ligjin 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe SH.Ç.B.A-së”. Në këtë program janë përcaktuar objektivat, prioritetet dhe masat për realizimin me sukses të procesit të vlerësimit.
- U ngrit Grupi i Punës për përgatitjen e akteve në lidhje me përshkrimin e punës, standardizimin e kushteve që duhet të plotësojnë kandidatët për funksion anëtar të trupës vlerësuese, si dhe çdo akt tjetër që gjykohet i nevojshëm për vijim e punës.
- Eshtë realizuar procesi i rekrutimit të anëtarëve të Trupës Vlerësuese, proces i cili ka kaluar nëpërmjet një konkurimi të hapur, transparent dhe duke respektuar të gjitha fazat e përcaktuara në ligj:
 - a) shqyrtimi i dosjeve të aplikantit
 - b) testimi me shkrim
 - c) intervista me gojë dhe verifikimi i personalitetit të aplikantit.

Nga procesi i rekrutimit u përzgjedhën 12 punonjës. U hartuan, draftuan dhe miratuan të gjitha aktet implementuese të procesit të Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik. Për hartimin e akteve u administruan modelet dhe eksperiencat legislative sekondare më të mira të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionit të Jashtëm, e konkretisht:

- a) *Udhëzimi i Ministrisë së Brendshme nr.177 datë 16/07/2020 “Për procedurat e vlerësimit të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme.*
- b) *Rregullore “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurimin e të dhënave personale nga Trupat e Vlerësimit miratuar me urdhrin nr. 59, datë 27.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së.*
- c) *Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Trupave Vlerësuese me urdhrin nr. 60, datë 27.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së.*
- d) *Rregullore “Procedurat për hedhjen e shortit” me urdhrin nr. 61, datë 27.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së.*
- e) *Rregullore “Kodi Etik i sjelljes së Trupave të Vlerësimit” me urdhrin nr. 62, datë 27.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së.*
- f) *Rregullore “Për marrëdhëniet me median” me urdhrin nr. 63, datë 27.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së.*
- g) *Rregullore “Për hapat proceduralë të unifikuar” me urdhrin nr. 64, datë 27.07.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së.*

Këto akte sekondare rregulluese dhe implementuese janë konsultuar dhe me partnerët, të cilët kanë vlerësuar elementët përbërës, si të teknikës legislative ashtu dhe të përmbajtjes së tyre, duke shprehur dakordësinë.

Me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale u hartua dhe miratua programi i trajnimit për Trupën Vlerësuese. Për realizimin e këtij trajnimi u identifikuan institucione vendase dhe të huaja, të cilëve ju adresuam kërkesa specifike për zhvillimin e trajnimeve me ICITAP, Pameca, OSBE, SHISH, Policia e Shtetit, Garda e Republikës, DSIK, ILDKPKI dhe Prokuroria e Përgjithshme

Pjesëmarrja e trupave të vlerësimit në trajnimin e sipërpërmendur, të realizuar në Akademinë e Sigurisë dhe ambientet e Ministrisë së Brendshme u organizua në 2 grupe në zbatim të urdhrin nr. 183, datë 15.10.2020 “Për pjesëmarrjen në trajnim të Punonjësve të SH.Ç.B.A-së”. Nga Sektori i Trupës së Vlerësimit është hartuar një Database për administrimin dhe menaxhimin e vendimeve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, si dhe janë krijuar modelet e regjistrave që do të jenë në funksion të vlerësimit kalimtar.

Sektori i Poligrafit pranë Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, për periudhën Janar–Dhjetor 2020 ka realizuar:

- Hartimin e akteve nënligjore mbështetëse për Sektorin e Poligrafit.
- Kryerjen e 8 (tetë) ekzaminimeve poligrafike për kandidatët për Drejtues të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

- Kryerjen e 39 (tridhjetë e nëntë) ekzaminimeve poligrafike për kandidatët për Hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit.
- Kryerjen e ekzaminimeve poligrafike testuese për rritjen e profesionalizmit të ekzaminuesve.
- Kryerjen e ekzaminimeve të lejuara për anëtarë të mbështetësve ndërkombëtarë, për njohjen me procesin dhe produktin e tij.
- Kryerjen e takimeve me institucione ligjzbatuese, të cilat kanë pasur nevojë për asistencë në kuptimin e procesit të ekzaminimit poligrafik.
- Përgatitjen e data bazës ligjore si pjesë e Trupës Vlerësuese dhe familjarizimi me të.
- Pjesëmarrjen e Sektorit të Poligrafit në trajnimin e realizuar si pjesë e Trupës Vlerësuese, në realizimin e detyrës së Drejtorisë së Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik.

Kryerja e ekzaminimeve poligrafike për kandidatët për Drejtues të Byrosë Kombëtare të Hetimit është bërë në zbatim të kërkesës së ardhur nga Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Pas realizimit të ekzaminimeve, SPAK i janë dorëzuar 8 (tetë) Raportet Finale për çdo kandidat.

Me kërkesë të Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësues të Sektorit të Poligrafit dhe Drejtues të Shërbimit, kanë realizuar 17 takime specifike për procesin e ekzaminimit poligrafik dhe rezultatin final të tij. Këto takime janë zhvilluar me praninë dhe asistencën e misioneve Ndërkombëtare që kanë shfaqur një interes të shtuar për ekzaminimet poligrafike, mënyrat e kryerjes së tyre dhe përfitimeve nga kryerja e këtyre ekzaminimeve poligrafike.

VI.

DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

VI.1. Për menaxhimin e shërbimeve Logjistike, burimeve njerëzore dhe trajnimeve

- Përgatitja e projekt-buxhetit 2021-2023, si edhe përgatitja e fishë-projekteve për investimet, si edhe detajimi i buxhetit të vitit 2020
- Hartimi i projektit për rikonstruksionin e godinës së SHÇBA, marrja e Certifikatës së pronësisë së objektit (Ish - Arkivi i Ministrisë së Brendshme), administrimi i saj
- Kryerja e procedurave të inventarizimit të aseteve në përdorim të SHÇBA
- Gjatë po këtij viti, nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe ankesat janë rekrutuar 34 punonjës, nga të cilët 33 nga SHÇBA dhe 2 nga DAP.
- Janë zhvilluar gjithsej 4 procedura konkurimi gjatë vitit 2020.
- Kanë aplikuar për t'u bërë pjesë e SHÇBA-së 88 aplikantë
- Janë kualifikuar dhe kanë marrë pjesë në testim 69 kandidatë

(Për secilin konkurs është ndjekur procedura ligjore duke nisur nga njoftimi i vendeve vakante në faqen zyrtare në internet të SHÇBA-së dhe shtypin e shkruar).

- Janë larguar nga detyra 6 (gjashtë) punonjës me motivacione të ndryshme, si më poshtë:
 - 1 (një) me motivacionin “Me kërkesën e tij”
 - 1 (një) “Punonjës është marrë masa disiplinore përjashtim nga shërbimi”
 - 1 (një) “Liruar nga detyra”

- 2 (dy) punonjës janë përjashtuar nga detyra me vendim të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.
- 1 (një) Punonjës ka ndërruar jetë
- Zhvillimin e trajnimit të brendshëm për personelin e rekrutuar rishtazi nga personeli me përvojë të gjatë profesionale në strukturat e Shërbimit dhe jo vetëm, mbi bazën e “Programit të Trajnimit të Brendshëm”, miratuar nga Drejtori i Shërbimit, janë trajnuar 137 (njëqind e tridhjetë shtatë), nga të cilët 135 punonjës të nga SHÇBA dhe Akademia e Sigurisë dhe 2 nëpunës civilë nga DAP punonjës gjithsej

VI.2.1. Masat disiplinore

Praktikat shkresore për hetimin disiplinor ndaj 4 punonjësve të SHÇBA

- 2 masa të lehta disiplinore “Vërejtje me shkrim”
- 1 masë disiplinore “Përjashtim nga Shërbimi”
- 1 masë disiplinore “Shtyrje e afatit të gradimit”

VI.3. Për rrjetet dhe sistemet e TI-së

1. Monitorimi i vazhdueshëm i rrjetit dhe zgjidhja e problematikave në qendër dhe në qarqet që shtrihet rrjeti i SHÇBA-së, detyrë e cila zgjidhet nëpërmjet funksioneve, si mirëmbajtja, monitorimi dhe zgjidhja e problematikave të serverave (20 makina virtuale) dhe pajisjeve fundore (Switch, Router, Kompjuter, Printer, Fotokopje, Skaner) në mënyrë të përditshme.
2. Mirëmbajtja e sistemit të data bazës së thirrjeve telefonike të linjës së gjelbër 0800 90 90, nëpërmjet Call Browser.
3. Miratimi i procedurave standarde të punës për Sektorin e TI-së.

VI.4. Projekte të realizuara për vitin 2020 në mënyrë të përmbledhur

1. Krijimi i bazës së të dhënave të Shërbimit, që sigurohen gjatë përmbushjes së veprimtarisë informativo-gjurmuese, hetimit administrativ dhe penal të strukturave tona, gjë e cila është realizuar gjatë vitit nëpërmjet projektit “Portali SHÇBA”. Përfundimi i projektit u realizua në bashkëpunim me ICITAP, aktualisht është trajnuar i gjithë stafi i Shërbimit dhe kjo databazë aksesohet nga i gjithë stafi. Nga stafi i IT-së ndiqet në mënyrë të përditshme ky projekt, duke evidentuar, zgjidhur problematika deri në implementimin përfundimtar të tij.
2. Ndjekja dhe marrja në dorëzim e projektit “Analizim të dhënash” për Drejtorinë e Analizës dhe Hetimit. Nga stafi i IT-së janë ndjekur gjithë procedurat e implementimit të programit i2-iBase data bazës së programit. Është ngritur, instaluar dhe konfiguruar serveri në funksion të programit të analizës sipas specifikimeve dhe kriterëve të vendosura nga kompania kontraktuese.

Pasqyra përmbledhëse e realizimit të shpenzimeve buxhetore të artikujve kryesor të strukturës buxhetore, për vitin 2020;

(në lekë)

<i>N r.</i>	<i>Art.</i>	<i>Emërtimi</i>	<i>Plani</i>	<i>Realizimi</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Real. në %</i>
1	600	Paga & shpenz. personeli	145,859,000	142,778,084	3,080,916	98%
2	601	Sigurime shoqerore	24,154,000	23,614,045	539,955	98%
3	602	Mallra e shërbime	27,425,500	26,133,257	1,292,243	95%

4	606	Transf.buxhetet familjare	5,550,000	5,539,603	10,397	100%
5	230	Shpenz. për rritjen e aktiveve të trupëzuara	14,700,000	12,155,460	2,544,540	83%
6	231	Shpenz. për rritjen e aktiveve të trupëzuara	21,400,000	21,399,205	795	100%
TOTALI			239,088,500	233,619,654	7,468,846	97%

VII.

PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021

Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, në kuadër të prioriteteve të Programit të Qeverisë Shqiptare 2017 – 2021, për Ministrinë e Brendshme; do të ketë për një periudhë pesë vjeçare prioritetet dhe objektivat të parashikuara në dokumentin strategjik të Shërbimit 2020 - 2024.

Gjithsesi, veprimtaria që përbën sfidë për SHÇBA, mund të sintetizohet në aksiomën “Efiçencë për të mbikëqyrur ushtrimin e autoritetit Policor të organeve të tjera ligjzbatuese dhe parandaluar shkeljet e ligjshmërisë e korrupsionin, me qëllim që të mbrohen gjithnjë e më mirë të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve”.

Lufta kundër paligjshmërisë dhe korrupsionit në veprimtarinë e organeve nuk duhet kuptuar e fokusuar vetëm tek ndryshimet ligjore, apo punonjësit e veçantë që abuzojnë në polici, por tek zhvillimi i standardeve të organizatës dhe policimit, duke forcuar integritetin dhe kombinuar masat parandaluese me ato shtrënguese, si dhe duke bashkërenduar veprimet me institucionet e tjera shtetërore, ato të drejtësisë e komunitetin.

Në këtë kuptim, bazuar në analizën e mësipërme, gjetjet, rekomandimet dhe reformat që e presin zhvillimin institucional të Shërbimit, për vitin 2020, parashikohen dhe përcaktohen si synime prioritare:

Forcimi i integritetit të strukturave ligjzbatuese me objektiv

- Qasja moderne për të përmirësuar integritetin e policisë
- Zhvillimi i procesit të Vlerësimit Kalimtar dhe Periodik të punonjësve, për të mbrojtur e pasuruar më tej vlerat dhe integritetin e organeve dhe punonjësve, sipas kriterëve e procedurave të përcaktuara në legjislacion

Zhvillimi i standardeve të SHÇBA, për të krijuar një shërbim publik që funksionon mbi bazën e ligjit dhe parimeve demokratike; të hapur, dinamik, të besueshëm, efikas dhe eficient, transparent e kontrollueshëm, me objektiv

- Përmirësimi i infrastrukturës ligjore e organizative (ligjit organik i SHÇBA, akteve të tjera nënligjore, organizimit e funksionimit të Shërbimit) dhe përafrimi me ato të vendeve perëndimore, për të rritur efiçencën e Shërbimit dhe përmbushur misionin e ngarkuar
- Sigurimi i burimeve të duhura (njerëzore, materiale e teknologjike), për të krijuar kushtet e nevojshme dhe motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave

Përmirësimi i drejtimit dhe bashkëpunimit me organet që janë objekt i veprimtarisë; opinionin publik dhe aktorë të tjerë shtetërorë, shoqërorë, e të sipërmarrjes së lirë me objektiv

- Përmirësimi i menaxhimit të Shërbimit në të gjitha nivelet për të siguruar një Shërbim efikas dhe transparent, për të menaxhuar burimet dhe motivuar punonjësit në kryerjen e detyrave
- Forcimi i bashkëpunimit me organet që janë objekt i veprimtarisë së Shërbimit dhe punonjësit e tyre, organet e agjencitë e tjera publike dhe ato homologe, të rajonit e më gjerë.
- Forcimi i bashkëpunimit me publikun; median; organizma të shoqërisë civile, sipërmarrjen e lirë dhe qytetarët, për të rritur besimin e mbështetjen në kryerjen e detyrave.

Rritja e performancës së shërbimit, për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e shkeljeve të ligjit, korrupsionit e veprave të tjera penale në radhët e punonjësve të organeve, për të mbrojtur integritetin e veprimtarinë e rregullt shtetërore dhe të drejtat e liritë themelore të shtetasve me objektiv

- Sigurimi i informacionit duke përdorur të gjitha burimet dhe mjetet e mundshme ligjore dhe administrimi i tij për njohjen e gjendjes, parandalimin e zbulimin e veprave korruptive
- Trajtimi i ankesave të qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme, me objektivitet e transparencë
- Inspektimi i strukturave ligj zbatuese, për të parandaluar shkeljet ligjore në ushtrimin e autoritetit dhe kompetencave të dhëna nga ligji
- Hetimi i shkeljeve të ligjit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale të kryera nga punonjës të organeve shtetërore që janë objekt i veprimtarisë së Shërbimit